




UNICEF
SHQIPËRI

PROJEKTI CLEEN – FLETORJA E NXËNËSIT


KLASA E PESTË

Pergatitur nga: Raiha Idrees

Emri im eshte _____

**Une dua qe Shqiperia ime te jete e bukur dhe
e paster**

UJI



UJI

PËRDORENI

ME KUJDES

Tema: Cikli i ujit


Aktiviteti # : Një

Aktiviteti: Vizatimi i ciklit të ujit

Materialet: lapustila, lapsa me ngjyra, laps, gomë

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Vizatoni një diagramë të thjeshtë të ciklit të ujit. Vërinë emrin çdo proçesi.



Tema : Burimet kryesore të ujit në botë


Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Identifikimi i burimeve të ujit në botë

Materialet: Atlas, etiketa, spango e kuqe, skedina

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Në vijim gjendet një hartë që tregon oqeanet dhe detrat e botës. A mund t'i gjeni ato në hartë? Përpiquni të gjeni oqeanet që këtu i kemi shënuar me gërma dhe detrat që u kemi vënë numëra. Ju mund të përdorni spangon e kuqe për të treguar ku gjenden detet dhe oqeanet dhe mund të shkruani emrat e tyre tek skedinat.



Tema: Uji

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Krijimi i një kopështi në enë qelqi

Materiale: Enë qelqi ose plastike e madhe, bimë, dhe, guralecë, ngjitëse, gazetë për të bërë kaush

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Kopësht në enë qelqi

Krijimi i një kopështi në enë qelqi apo i një mini kopshti në një terrarium apo në një akuarium të vogël është shumë argëtuese. Ky lloj kopështi është vendi ideal për bimë të vogla që duan kushte të lagështa.

Kujdes duhet bërë për të gjetur bimët e duhura dhe për t'i futur bimët në enë, por kjo e bën akoma më argëtuese aktivitetin. Më të përshtatshme janë enët e gjera e të rrumbullakëta.

Mund të gjenden edhe enë të posaçme për këtë punë, sepse ky kopësht do të tërheqë vëmendjen e njerëzve që do të bëhen kuriozë për të parë çka brenda.



Mund të zgjidhen damixhanë vere, akuariume të vogla apo kavanoza të mëdhenj reçeli që mund t'i vendosim drejt apo në një anë.

Mund të zgjidhen bimë e lule të vogla për kopështin në miniaturë. Ato mund t'i merrni nga ato që keni në shtëpi, por mund të përdorni edhe fara. Zgjidhni lulet me ngjyra të ndryshme për ta bërë kopshtin tuaj sa më të larmishëm dhe lëruni hapësirë midis tyre që të rriten.

Bimë të përshtatshme janë fieret, palmat e dhomës, vjollcat, begonjat dhe kacavjerrëset. Të gjitha duhet të jenë të llojit miniaturë. Pasi vendosen në enë ato kërkojnë shumë pak kujdes. Uji që hidhet brenda avullon dhe kondensohet në anët e enës duke u kthyer mbrapsht në komposton që kemi vendosur në enë.



Do të duhet t'i ujisim një herë në tre apo gjashtë muaj. Dritë kërkojnë shumë, por duhet të mos i lemë drejt e në diell sepse mund të digjen.

Krasitini lulet që rriten shpejt dhe hiqni menjëherë gjethet e vyshkura që të mos krijojmë mundësi për përhapjen e sëmundjeve.

Mbjellja e kopshtit në enë

Lajeni dhe thajeni mirë enën. Ena duhet të jetë e pastër që të shohim lulet brenda saj. Nuk duhet të ketë njolla e shenja gishtash.

Në fund të enës duhet të krijojmë kushte për kullimin e ujit. Vendosni guralecë në një thellësi prej 2,5 cm. Mbulojini me komposto myshku e bimësh të thata të njomur së pari me pak ujë.

Përpiquni të shmangni prekjen e anëve të enës në kohën që krijoni kopshtin. Është e vështirë të pastrohet pasi të kemi vendosur lulet. Përdorni gazetën të bërë kaush përë të vendosur komposton në enë.

Përdorni një shkop të hollë për të shpërndarë komposton dhe për të hapur vrimat për lulet. Nëse ena që përdorni është me grykë të ngushtë do të duhet shumë kujdes dhe mjete të posaçme për të ulur bimët në enë dhe ndoshta do t'ju duhet të hiqni një pjesë të dheut që gjendet në rrënjët e lules.

Tema : Ruajtja e Ujit


Aktiviteti #: Katër

Activiteti: Kujtohuni të mos shpërdoroni ujin

Materialet: Gërshërë, ngjyra, spango

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Më poshtë është një kujtesë për të kursyer ujin. Vendoseni atë në vendet e duhura në shkollë dhe në shtëpi. Ngjyroseni dhe vareni shënimin në vendin ku uji zakonisht shpërdorohet që t'u kujtoni të gjithëve se uji duhet kursyer.



Tema: Uji

Activiteti #: Pesë

Activiteti: Fjalëkryq

Materialet: Laps e gomë

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje



Cikli i Ujit



Më poshtë jepen ide si të bësh një fjalëkryq. A mund të vendosni fjalët më poshtë në formë fjalëkryqi? Sigurohuni që fjalët të vendosura në mënyrë horizontale dhe vertikale të kenë kuptim. A është e lehtë të bësh një fjalëkryq?

P.sh.

Kristale akulli që bien nga qielli

B	O	R	A
---	---	---	---



Përmes

3. Kristale akulli që bien nga qielli.

6. Ujë që nxehet në gjendje të gaztë.

9. Shi i ngrirë.

10. Sistem uji që rrjedh në tokë.

12. Sistem i madh me ujë të kripur.

13. Procesi i kalimit nga avull në pika uji.

Poshtë

1. Nga vjen energjia që lëviz ciklin e ujit?

2. Proçesi i pikave të shiut apo kritaleve të akullit që bien nga qielli.

3. Sistem i vogël uji që rrjedh në tokë.

4. Proçesi i ujit që lëviz në botë me anë të precipitimit, avullimit dhe kondensimit.

5. Proçesi që e kthen ujin në avull.

7. Këto formohen në qiell kur avulli i ujit kondensohet në pika uji.

8. Një sistem i madh me ujë të rrjedhshëm.

10. Uji që rrjedh në lumenj dhe rrëke në detra dhe oqeane.

11. Pika uji që bien nga qielli.

Ajri



Tema : Ajri

Activiteti #: Një

Activiteti: Vizatoni procesin e fotosintezës

Materialet: lapustila, ngjyra, laps e gomë

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Vizatoni një diagramë të fotosintezës. Emërtoni proceset e ndryshme.

Tema: Ajri

Aktiviteti #: Dy

Aktivitete: Ndarja e vendeve me ajër të pastër nga ato me ajër të ndotur

Materialet: Shirita të bardhë, spango, topa pambulu, stilolapsa, etiketa, tabakë letre, ngjitëse

Hapi fëmijë-fëmijë: Zhulimi i fakteve

Hidhni sytë rreth e qark. A duket, ndihet dhe a ka aromë pastërtie ajri? Ju mund ta provoni ajrin rreth jush. Lidhni shiritat ose topat e pambukut me spango dhe vendosini në vende të ndryshme. Lëroni ku i keni varur për rreth një javë. Kur t'i hiqni pas një javë, merrni me vete etiketat që të shkruani emrin e vendit ku kishit vënë shiritat apo topat e pambukut.

Shikoni ngjyrën e shiritit/topit? Me se janë mbuluar? Cili vend rezulton më i ndoturi, po më i pastërti? Në një tabak letre vizatoni hartën e vendit ku kishit vendosur shiritat/topat. Vëruni emrin zonave. Ngjitini shiritat/topat në vendin ku i kishit vendosur ato.

Me lapustil të kuq, shënoni zonat më të ndotura duke shkruar cili është shkaku i ndotjes sipas jush. Pastaj shënoni zonat më të pastra duke shkruar pse janë të pastra sipas mendimit tuaj.

Diskutojeni hartën me nxënës të tjerë ose me anëtarë të familjes. Çfarë mund të bëni ju të gjithë bashkë për ta bërë ajrin më të pastër? Ç'masa mund të merrni? Për sa kohë do të zbatoni masat që mendoni të merrni? Kush do ta masë rezultatin e masave tuaja?

Tema: Ajri

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Vizatimi i shenjës "ndalohet duhani" dhe anketimi i duhanpirësve


Materialet: Tabakë letre, bojë, furcë, laps, dhe formularë pyetsorësh.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Anketoni duhanpirësit e lagjes tuaj. Do t'ju duhet të bëni një formular me pyetje. Çfarë pyetjesh do të vendosni në formular? Ja një sugjerim:

- "Pini duhan? Po Jo"

Bëni tani një grafik të atyre që pijnë dhe që nuk pijnë duhan. Sugjerim: Grafiku mund të jetë si më poshtë...



- Gjeni përqindjen e atyre që pijnë dhe që nuk pijnë duhan. A e mbani mend si bëhet kjo?
- Tani mund të bëni një apo më shumë shenja (në vartësi të situatës) për të nxitur njerëzit të mos pijnë duhan. Shenja duhet të jetë një sinjal për të mos pirë duhan dhe ju keni rast të tregoni gjithë krijimtarinë tuaj:



Tema: Ajri

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Eksperimentimi me ajrin

Materialet: copë, shishe qelqi, enë me ujë, letër, laps

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Eksperiment: *Grisni dy copa rrobe dhe vendosini në një shishe qelqi. Vendoseni shishen përmbys në pozicion vertikal në një enë me ujë. Ajri në shishe shërben si pengesë për ujin dhe copat mbeten të thata. Diskutoni atë që shikoni. Çfarë mësojmë nga ky eksperiment? Pse ajri është i rëndësishëm për ne? Në një letër, shkruani të paktën 20 tipare të rëndësishme të ajrit. Nëse në mend ju vijnë më shumë se kaq, aq më mirë.*

TOKA



Tema: Toka dhe sistemi diellor


Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Të bëjmë një model të sistemit diellor

Materialet: përdorni shishe të riciklueshme, gazeta, materiale të ndryshme, ngjitës, gërrshërë, bojë

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Ndoshta në shtëpi dhe në shkollë gjenden shumë materiale të riciklueshme. Tani keni rastin të tregoni krijimtarinë tuaj. Mblidhni materiale që janë për t'u hedhur, si gazeta, shishe qelqi apo plastike, varëse rrobash, topa tenisi, letër alumini, etj. Me këto materiale krijoni një model të universit tonë. Është më dorën tuaj ta bëni me shumë apo me pak detaje. Mund të vendosni ta bëni me hënën dhe me asteroidet, por mund ta bëni edhe thjesht fare. Kushti është të vendosni diellin dhe të gjitha planetet. Përpiquni të jeni sa më krijues dhe përdorni VETËM materiale të riciklueshme. Mund të jetë tre dimensional, ose një dimensional. Kjo varet nga ju, por duhet të jetë i kuptueshëm dhe tërheqës. Gëzohuni me sistemin tuaj diellor.



Tema: Toka

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Ku jetojnë kafshët e ndryshme?

Materialet: Hartë e botës, piktura apo vizatime të kafshëve, letër për postera, bojë

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Shikoni pikturën këtu poshtë. Pse kërkojnë ndihmë këto kafshë? Çfarë është e përbashkët për ta? A i njihni ato me emër? Sa kafshë zhduken çdo ditë? Cilat kafshë po zhduken në Shqipëri? Në hartën e botës, shënoni vendet ku jetojnë këto kafshë. Bëni një poster që të ndihmoni në shpëtimin e kafshës tuaj të preferuar. Çfarë doni t'u thoni shokëve? Pse kafsha që keni zgjedhur është e rëndësishme dhe pse duhet shpëtuar nga zhdukja?



NA NDIHMONI!!!



Tema: Toka dhe Universi

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të sjellim ndër mend rendin e vendosjes së planeteve.

Materialet: Laps dhe gomë.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

A mund të bëni një fjali që ju ndihmon të sillni ndër mend rendin dhe emrin e planeteve? Fjalja duhet të ketë fjalë që fillojnë me germën e parë të planeteve. Rendi duhet të ndjekë rradhën e vendosjes së planeteve në univers. Përpiquni. Sugjerim: Filloni me diellin, vazhdoni me mërkurin, venusin dhe pastaj tokën... Fjalja juaj duhet të ketë një **D** pastaj një **M** më pas një **V** dhe një **T**. Tani vazhdoni me të gjithë sistemin diellor. Mund ta bëni?

Tema: Toka

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Loja e kërimit të fjalëve

Materialet: laps e gomë

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

A e dini c'është loja e kërimit të fjalëve? Është një kuti me shumë shkronja dhe nga këto shkronja zgjidhet fjala e duhur nga disa shkronja duke i rrethuar ato. Mendoni që mund të krijoni një lojë të kërimit të fjalëve? Ju mund të përdorni fjalët kyc që keni mësuar në këtë modul. Moduli i tokës ka shumë fjalë që ju mund t'i përdorni, psh qiell, ylber, i kuq, portokall, re, shi, blu, etj. Në tabelën më poshtë krijoni një lojë të kërimit të fjalëve dhe shkruani fjalët në një listë të vecantë që të tjerët t'i gjejnë. Shikoni nëse mami, babi ose vëllezërit e motrat mund t'i gjejnë fjalët!

Lista e fjalëve:

NATYRA



Tema: Natyra

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Të lexojmë dhe të vizatojmë natyrën

Materialet: tregim ose poemë, laps e gomë.

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Zgjidhni një poemë apo tregim që flet për natyrën. Duke përdorur imagjinatën, nga tregimi që dëgjuat, bëni një pikturë për mënyrën e përshkrimit të natyrës.

POEMË OSE TREGIM	PIKTURË


Tema: Ekosistemi

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Të vizatojmë një ekosistem

Materialet: Letër, bojë, laps.

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve



Shikoni pikturën më lart. Cila është marrëdhënia midis krimbit dhe lules? Çfarë i ndodh krimbit? Kush e ha bretkocën? Çfarë bën bufi? Çfarë do të ndodhte sikur të mos kishte lule? Çfarë do të ndodhte sikur një nga kafshët të mungonte në zinxhirin ushqimor? A mund të thoni pse janë të rëndësishëm zinxhirët ushqimorë? A mund të mendoni vetë një zinxhir ushqimor? Pse nuk vizatoni një zinxhir ushqimor duke vënë edhe emrat e çdo pjesëmarrësi në këtë zinxhir?

Tema: Natyra

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Matja e lartësisë së pemës


Materialet: trekëndësh kënddrejtë me lavjerrës, metër shirit

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Përdorimi i trekëndëshit kënddrejtë me lavjerës, për matjen e lartësisë së pemës.

Caktojmë pemën që duam të matim dhe më pas vendosemi në një distancë të tillë nga pema deri sa ta shohim me sy (syri tek thepi ^(B)) që thepi ^(A) i trekëndëshit të jetë pozicionuar tek maja e pemës dhe lavjerësi të jetë pingul. Zhvendosemi para mbrapa derisa këto parametra të jenë vendosur.

Pasi të jetë bërë kjo shënojmë pozicionin ku jemi dhe matim distancën nga vendi deri tek pema dhe i shtojmë kësaj edhe lartësinë nga toka tek syri (syri i personit që ka bërë matjen). Shuma e tyre jep lartësinë e pemës.



Tema: Bukuritë e tokës

Aktiviteti #: Kater

Aktiviteti: Të bëjmë një kartolinë

Materialet: shënjes, kartela 8X12, adresë shtëpie, dhe pullë poste

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

E keni idenë si është një kartolinë? Këtu keni disa shembuj. A mund të bëni një kartolinë një tregon bukuritë natyrore të Shqipërisë? Mund të shkruani një mesazh që bën thirrje për ruajtjen e natyrës dhe ta dërgoni në adresën e shtëpisë tuaj.



Tema: Natyra

Aktiviteti #: Pese


Aktiviteti: Në kërkim të kafshëve të vogla

Materialet: lopatë, një metër katror tokë, laps plumbi, lapsa me ngjyra, letër, spango, 4 shkopa, dhe metër

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Gjeni një vend në oborrin e shtëpisë ose në oborrin e shkollës. Mateni vendin që të jetë 1m me 1 m. Vendosini 4 shkopinjtë në të katër qoshet. Lidhni spangon në të katër shkopinjtë. Gërmoni brenda kësaj sipërfaqeje dhe shikoni me kujdes gjallesat që do të gjeni aty. Shikoni me vëmendje kafshët e vogla. Çfarë keni gjetur? Bëni një pikturë për të treguar se çfarë keni gjetur në vendin ku keni gërmuar.

NDOTJA



Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Lexim gazete dhe hartim

Materialet: gazetë, laps, gomë, poster, ngjitës, gërshtërë.

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit



Lexoni një gazetë (p.sh. Ekolëvizja ose të tjera) dhe gjeni lajmet që flasin për ndotjen në Shqipëri dhe në të gjithë botën. Cilat lloje të ndotjes trajtohen në artikull. Cilët janë disa nga ndotësit që shkaktojnë ndotjen në Shqipëri. A është ndotja problem serioz tek ne? A ka vende në botë pa ndotje? Pse është e rëndësishme të jemi pa ndotje? Pritini artikujt dhe ngjitini mbi një letër poster. Shkruani disa fjali për të përmbledhur artikullin duke u përqëndruar tek ndotja dhe llojet e ndotësve që trajtohen aty.

Tema: Ndotja


aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Leximi i grafiqeve që flasin për ndotësit e ajrit.

Materialet: letër, laps.

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Rritja e shpejtë e numrit të makinave, mosha e vjetër e makinave dhe cilësia e dobët e Karburantit janë faktorët kryesorë që shkaktojnë ndotjen e ajrit në Shqipëri. Më poshtë është një grafik që ilustron rritjen e numrit të makinave në Shqipëri, pas vitit 1990. Shikoni grafikun dhe përgjigjuni pyetjeve më poshtë:



Cila mënyrë transporti është shtuar shumë dhjetë vitet e fundit?

Në vitin 1996 cili ishte numri i kamionëve?

Në cilin vit arritën autobusat numrin 40000?

Në vitin 2000 sa ishte ndryshimi midis makinave dhe autobuzave?

Pse mendoni që makinat janë shtuar kaq shumë dhjetë vitet e fundit?

Cfarë ndikimi në mjedis do të ketë rritja e numrit të makinave?

Si mund të ndihmojmë ne në zgjidhjen e këtij problemi?

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Marrja e një zotimi dhe krijimi i një posteri

Materialet: letër posteri, bojë, laps.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi



Keni studjuar llojet e ndryshme të ndotjes. Zgjidhni *një* lloj ndotjeje dhe bëni një poster për të informuar të tjerët për pasojat e dëmshme që ka ndotja. Së dyti, konceptoni një zotim që ju, familja dhe shokët tuaj do të marrin për të kundërshtuar pasojat e asaj lloj ndotjeje. Për shembull, nëse zgjidhni ndotjen e ajrit, edhe posterin duhet ta bëni për ndotjen e tij dhe ndikimin negativ që ka. Së treti, duhet të merrni zotimin për të ndihmuar që të mos ndotet ajri duke caktuar edhe veprimin që do të bëni. Shkruajeni zotimin tuaj në një letër çertifikate si shembulli më lart dhe kërkoni që ta firmosin të gjithë ata që duan ta zbatojnë. Caktoni një afat dhe kontrolloni mbatjen e zotimit. A ka qenë e lehtë apo e vështirë? Thoni ç'ka qenë e lehtë dhe ç'ka qenë e vështirë.

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Mbledhja e plehrave rreth shtëpisë dhe rreth shkollës.

Materialet: letër, qese letre.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Plehra, plehra, kudo... Këtu keni një këngë, por ju mund të krijoni vetë një këngë dhe t'ua këndonit shokëve dhe njerëzve të shtëpisë:

PARANDALIMI I NDOTJES /BËHU I ZGJUAR KUR SHKON PËR PAZAR

Nëse ka plehra kudo rreth e rrotull,
Hidhi në kosh! Shpëto planetin!
Nëse ha karamеле, mos i hidh letrat në rrugë.
Hidhi në kosh! Shpëto planetin!

Kori:
Ne e duam ujin dhe e duam ajrin,
Pra, mos i hidhni plehrat ku të mundni,
Ka një kosh të veçantë për ca gjëra,
që ne i quajmë të riciklueshme!

Kur të keni mbaruar akulloren dhe u ka mbetur vetëm kaushi, vëreni shpejt në vendin e duhur.
Hidhe në kosh! Shpëto planetin!
Kur të kesh mbaruar së paketuari, ushqimin që do marrësh me vete në shkollë,
Hidhi mbetjet në kosh! Shpëto planetin!

Kori:
Rëndësi ka që të dish ç'të bësh.
Hidhe në kosh! Shpëto planetin!
Hidhe në kosh! Shpëto planetin!
Oh, hidhe në kosh! Shpëto planetin!


Ju mund të ndihmoni për të shpëtuar planetin duke bërë një fushatë për mbledhjen e plehrave. Mblidhni plehrat përreth shkollës. Duke dhënë shembullin tuaj, do t'u tregoni nxënësve më të vegjël të mos ndotin mjedisin dhe t'i hedhin plehrat në kosh. Shikoni cilat zona rrotull shkollës janë më të ndotura dhe pse. Si mund ta parandaloni këtë? Ndoshta mund të bëni kosha me kuti të riciklueshme që të ketë më shumë vende për të hedhur plehrat. Mund të bëni postera ose parrulla për t'u kujtuar më të vegjëlve të mos i hedhin plehrat gjithandej. A ka gjëra të tjera që mund të bëni? Me siguri! Shumë gjëra mund të bëhen.

Aktiviteti: Diskutimi i pikturës.

Materialet: laps e letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Shikoni me kujdes pikturën më poshtë. Me pak fjali, përpiquni të përshkruani çpo ndodh në atë pikturë. Ku përqëndrohet kjo pikturë? Çfarë mesazhi përpiqet të japë?



MBESHTETUR NGA:

UNICEF ALBANIA



THE CHILD TO CHILD TRUST



AMBASADA E MBRETERISE HOLLANDEZE



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCES

INSTITUTI I KURRIKULES DHE TRAINIMIT



MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE

ADMINISTRIMIT TE UJERAVE

